



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.37/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Srpska Lista, me seli në Mitrovicë të Veriut për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.37/2025, e datës 15.09.2025, parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Srpska Lista, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.09.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se më datë 13.09.2025, subjekti politik Srpska Lista gjatë tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore ka ekspozuar parullën “*svi za brata milana*”, duke shprehur kështu përkrahjen për Milan Radojiçiq, i cili është shpallur në kërkim nga institucionet e Republikës së Kosovës si organizator i sulmit terrorist në Banjska të vitit 2023. Sipas parashtruesit të ankesës ekspozimi i kësaj parulle përbën glorifikim të terrorizmit dhe nxitjes të urrejtjes politike dhe etnike. Me këtë veprim subjekti politik Srpska Lista ka shkelur dispozitat e nenit 34, paragrafi 1, pika 11 e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke plasuar parullat nxitëse të urrejtjes, dhe marrë parasysh aktivitetin kriminal e terrorist të Milan Radojiçiqt, për çka i njëjti ka aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Tutje, parashtruesi i ankesës ka theksuar se që nga 15 Prill 2025, Milan Radojiçiq ka edhe një fletëarrest si i dyshuar për krime lufte në periudhën 1998-1999, përkatësisht pjesëmarrje në vrasjen e 106 civilëve shqiptarë, kufomat e të cilëve u gjenden më vonë në Batajnicë të Sërbisë. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe

argumentet e lartcekura, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Lista ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se nuk kemi vepruar në kundërshtim me ligjet dhe rregullat që rregullojnë aktivitetet zgjedhore. Në takimin e përmendur të Listës Serbe, transparenti i përmendur është shkruar dhe dedikuar ekskluzivisht kandidatit tonë për kryetar të Mitrovicës Veriore, Milan Radojeviçit, dhe që përfaqëson një thirrje për qytetarët që në zgjedhjet lokale të ardhshme, të cilat do të mbahen më 12 Tetor, në përputhje me parimet demokratike, të japin votën e tyre për kandidatin tonë, zotin Milan Radojeviç. Fakti që kandidati ynë ka të njëjtin emër si Milan Radoiçić është një rastësi. Dhjetëra mijëra serbë kanë emrin Milan, dhe kjo nuk mund të ndalohej apo ndëshkohet sipas ligjit, përveçse çdo individ është një individ për vete dhe nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet e ndonjë personi tjetër, sidomos jo për shkak se ka të njëjtin emër si një person tjetër. Nëse interpretimi i Lëvizjes Vetëvendosje do të merrej si i rëndësishëm, lind pyetja nëse ka bërë shkelje edhe KQZ-ja duke shtypur mijëra fletëvotimi me emrin e kandidatit tonë për kryetar të Mitrovicës Veriore ose broshura për informimin e zgjedhësve me emrat e kandidatëve? A kanë bërë shkelje edhe anëtarët e KQZ-së nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që kanë votuar për fletëvotimin ku është shkruar emri "Milan"?

Tutje ka shtuar, në vetë konventën, kandidati për këshilltar dhe bartësi i listës, Ivan Zaporozac tha, citoj: "Që të jetë e qartë për të gjithë, ju lutem, më 12 Tetor, të gjithë për Milan Radojeviçin për kryetar. Të gjithë për Milan!". Si provë kanë bashkangjitur materialin video në një USB, si dhe i njëjti tekst mund të shihet në lidhjen video që ka publikuar portali KOSSEV në lidhjen: <https://www.facebook.com/kossevportal/videos/810556874741219/?t=o>. Shpjegimi i këtij transparenti, vetëm një ditë pas mbajtjes së konventës, dhe një ditë para se Lëvizja Vetëvendosje të dorëzonte ankesën, e dha edhe funksionari i Listës Serbe, Igor Simić, në një intervistë për televizionin Prva, kur tha, citoj: "Ishte aty edhe një transparent i madh 'Të gjithë për vëllain Milan!'" që dikush e interpreton kështu ose ashtu. Ne e dimë mirë për kë ishte ai mesazh. Kandidati ynë për kryetar të komunës është Milan Radojević, një serb i ndershëm që do të mbrojë interesat e popullit serb..." fundi i citatit. (lajmi i printuar është publikuar në shumë portale, të cilat i bashkëngjitem në aneks). Prandaj, kjo ankesë e Lëvizjes Vetëvendosje nuk ka asnjë provë për shkeljen e kryer, por përfaqëson një përpjekje për të mashtruar, përmes shpikjeve, sulmeve të pabazuara dhe insinuatave, gjyqtarët e nderuar të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtresa. Me këtë interpretim dhe paraqitjen e një anese të pabazuar, Lëvizja Vetëvendosje vetë ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nr. 08/L-228, konkretisht nenin 34, pika 1, paragrafi 10, pasi ka abuzuar me të drejtën e ankesës, duke paraqitur ankesa të rreme, pa vlerë dhe irrituese për PZAP-në. Të gjitha veprimet në mbledhjen publike janë realizuar në përputhje me ligjin dhe nën mbikëqyrjen e plotë të organeve përkatëse zgjedhore, duke respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat që përcakton Ligji i Përgjithshëm për Zgjedhjet. Bazuar në të gjitha të mësipërmet, dhe në përputhje me nenin 118 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, kanë propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

- *Ankesa është e pabazuar.*

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, përkatësisht, deklarimi se subjekti politik Srpska Lista gjatë tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore ka ekspozuar parullën “*svi za brata milana*”, duke shprehur kështu përkrahjen për Milan Radojqiç, i cili është shpallur në kërkim nga institucionet e Republikës së Kosovës si organizator i sulmit terrorist në Banjska të vitit 2023, nuk ka mundur të argumentohet me asnjë provë, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, Bazuar në këtë subjekti politik LVV përmes fotografisë së bashkangjitur nuk dëshmon se në parullën e lartpërmendur është aluduar në personin Milan Radojqiç, rrjedhimisht në të njëjtën përmendet vetëm emri “Milan”, i cili është emri i kandidatit për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut, Milan Radojeviç.

Sipas vlerësimit të Panelit ky tubim lidhur me hapjen e fushatës zgjedhore nga subjekti politik Lista Serbe është mbajtur për zgjedhjet lokale të datës 12.10.2025 në të cilën kandidati i këtij subjekti për kryetar të kësaj komune - Mitrovicë së Veriut është personi me emrin Milan Radojeviç, gjë që vërtetohet dhe nga vetë fletëvotimet e aprovuara nga KQZ për zgjedhjet lokale në Mitrovicën e Veriut, andaj dhe nënkuptohet se kjo parullë ka të bëjë me përkrahjen për kandidatin në fjalë, e jo me personin të cilin aludon subjekti ankues, andaj dhe në mungesë të provave nuk mund të vërtetohen pretendimet e parashtruesit të ankesës, Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.37/2025, datë 17.09.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

AA.nr.82/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Rustem Thaqi dhe Franciska Zhitija-Ymeri anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025, në seancën e mbajtur më datë 22.09.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025, është vendosur: REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.37/2025, e datës 15.09.2025, parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Srpska Lista, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

Kundër këtij vendimi subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata



Supreme e Kosovës të: Shfuqizojë vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025, dhe të gjejë fajtor subjektin politik Lista Serbe për nxitje të urrejtjes sipas Kodit të Mirësjelljes.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 15.09.2025, subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin ka theksuar se: subjekti politik Srpska Lista gjatë tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore ka ekspozuar parullën “*svi za brata milana*”, duke shprehur kështu përkrahjen për Milan Radojiçiq, i cili është shpallur në kërkim nga institucionet e Republikës së Kosovës si organizator i sulmit terrorist në Banjska të vitit 2023. Sipas parashtruesit të ankesës ekspozimi i kësaj parulle përbën glorifikim të terrorizmit dhe nxitjes të urrejtjes politike dhe etnike. Me këtë veprim subjekti politik Srpska Lista ka shkelur dispozitat e nenit 34, paragrafi 1, pika 11 e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke plasuar parullat nxitëse të urrejtjes, dhe marrë parasysh aktivitetin kriminal e terrorist të Milan Radojiçiqt, për çka i njëjti ka aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Tutje, parashtruesi i ankesës ka theksuar se që nga 15 Prill 2025, Milan Radojiçiq ka edhe një fletë arrest si i dyshuar për krime lufte në periudhën 1998-1999, përkatësisht pjesëmarrje në vrasjen e 106 civilëve shqiptarë, kufomat e të cilëve u gjenden më vonë në Batajnicë të Serbisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL.Anr.37/2025, të datës 17.09.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, përkatësisht, deklarimi se subjekti politik Srpska Lista gjatë



tubimit të hapjes së fushatës zgjedhore ka ekspozuar parullën “svi za brata milana”, duke shprehur kështu përkrahjen për Milan Radojqiç, i cili është shpallur në kërkim nga institucionet e Republikës së Kosovës si organizator i sulmit terrorist në Banjska të vitit 2023, nuk ka mundur të argumentohet me asnjë provë, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, Bazuar në këtë subjekti politik LVV përmes fotografisë së bashkangjitur nuk dëshmon se në parullën e lartpërmendur është aluduar në personin Milan Radojqiç, rrjedhimisht në të njëjtën përmendet vetëm emri “Milan”, i cili është emri i kandidatit për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut, Milan Radojeviç. Sipas vlerësimit të Panelit ky tubim lidhur me hapjen e fushatës zgjedhore nga subjekti politik Lista Serbe është mbajtur për zgjedhjet lokale të datës 12.10.2025 në të cilën kandidati i këtij subjekti për kryetar të kësaj komune - Mitrovicës së Veriut është personi me emrin Milan Radojeviç, gjë që vërtetohet dhe nga vetë fletëvotimet e aprovuara nga KQZ për zgjedhjet lokale në Mitrovicën e Veriut, andaj dhe nënkuptohet se kjo parullë ka të bëjë me përkrahjen për kandidatin në fjalë, e jo me personin të cilin aludon subjekti ankues, andaj në mungesë të provave nuk mund të vërtetohen pretendimet e parashtruesit të ankesës, Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar të pabazuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore, dhe se parulla e përdorur nga subjekti politik Srpska Lista nuk përbën shkelje të nenit 34 [Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike], të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e



Kosovës, ku është përcaktuar se: *“1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Lidhur me pretendimin se parulla “Svi za brata Milana” përbën glorifikim të terrorizmit dhe nxitje të urrejtjes, gjykata vlerëson se pala ankuese nuk ka paraqitur prova të qarta dhe bindëse që do të vërtetonin se parulla në fjalë i referohej Milan Radojiçiqit, dhe jo kandidatit për kryetar të komunës nga radhët e subjektit Srpska Lista, Milan Radojeviq. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se: në parullën e kontestuar nuk përmendet mbiemri i personit, por vetëm emri “Milan”, i cili është emër i përhapur në komunitetin serb dhe figuron edhe në listën zgjedhore të KQZ-së. Lista Serbe, ka ofruar shpjegim të arsyeshëm, se parulla i referohej kandidatit të tyre për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut.

Lidhur me pretendimin se parulla ka pasur ndikim manipulues ose frikësues ndaj votuesve, gjykata vlerëson se për të konstatuar një nxitje të dhunës apo të urrejtjes, duhet të vërtetohet se materiali i përdorur (në këtë rast parulla) ka pasur përmbajtje ose efekt real për të nxitur ose frikësuar qytetarët, gjë që nuk mund të supozohet vetëm mbi bazën e ngjashmërisë së emrave. Në mungesë të fakteve objektive që tregojnë për një ndikim të tillë, Gjykata nuk mund të pranojë si të mjaftueshme perceptimet apo interpretimet subjektive të palës ankuese.

Mbi barrën e provës dhe standardin ligjor, sipas nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe barra e provës bie mbi palën ankuese.”* Në këtë rast, Lëvizja Vetëvendosje, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj. Prandaj, edhe PZAP me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e këtij subjekti nuk mbështeten në prova faktike apo juridike, dhe ka refuzuar ankesën e saj. Pavarësisht se pala ankuese ka bërë referenca ndaj Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCPP), nuk është dëshmuar në asnjë pikë se e drejta për zgjedhje të lira është cenuar në mënyrë konkrete. Parulla e përdorur në konventën elektorale nuk përbën, në vetvete, një formë të drejtpërdrejtë të dhunës apo frikësimit zgjedhor. Interpretimi subjektiv nuk mund të zëvendësojë standardin ligjor të provës, i cili është objektiv dhe i bazuar në fakte.



Gjykata vlerëson se PZAP ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka vlerësuar drejt faktet dhe provat në shkresat e lëndës. Gjykata nuk gjen prova të mjaftueshme për të konkluduar se është bërë glorifikim i një personi të shpallur në kërkim apo se ka pasur qëllim për nxitje të urrejtjes ndëretnike, siç pretendon pala ankuese.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.82 /2025 me 22 shtator 2025

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-82/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL POSTAVNICAZALICNO POSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënies së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendjet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërkësës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primilac nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primilacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primilaca (priblieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijma

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AK7674K14

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primilca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.